

URDHËR
Nr. 174, datë 28.3.2023

PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENIN E SHKODRËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë të *Krapit – (Cyprinus carpio)* në liqenin e Shkodrës, për periudhën 1.4.2023 deri më 30.4.2023.

2. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë të *Gjubicës (cironkës) – Alburnus Albidus Alborella* në liqenin e Shkodrës, për periudhën 1.4.2023 deri më 31.7.2023.

3. Për periudhën 1.4.2023 deri më 30.4.2023 lejohet të peshkohet vetëm ngjala me grepa nga subjektet e pajisura me leje peshkimi nga Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të Liqenit të Shkodrës, siç është parashikuar në *Planin e Menaxhimit të Ngjalës*.

4. Për periudhën 1.5.2023 deri më 30.6.2023, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore prej 300 m nga bregu.

5. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë sipas zonave të përcaktuara nga Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të Liqenit të Shkodrës.

6. Për periudhën e lejimit të peshkimit të ngjalës, sipas pikës 3 të këtij urdhri, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të Liqenit të Shkodrës të ketë monitorim të sasive ditore të peshkuara.

7. Peshku i sekuestruar nga peshkimi i paligjshëm të groposet ose të shpërndahet për bamirësi.

8. Për zbatimin e këtij urdhri, të hartohet një *Plan i Përbashkët Operativ Veprimi* nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në koordinim me Organizatën e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës.

9. Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të Liqenit të Shkodrës të marrë të gjitha masat e zhvendosjes së objekteve ku peshqit kanë lëshuar vezët, në rastet e rënies së nivelit të ujit në liqenin e Shkodrës.

10. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të Liqenit të Shkodrës, Drejtoria Rajonale e AKU Shkodër, duke bashkëpunuar me strukturat e qeverisjes vendore, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare në qarkun e Shkodrës dhe Policinë Bashkiake të Shkodër dhe Malësisë së Madhe.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca